



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Kryetarja e Komunës

01nr _____

Dt: 27.08.2015

Kryetarja e Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 11, 13 dhe 58 shkronja a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03L-040, nenit 9, dhe 10, lidhur me nenin 2.2 të Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Komunale, me të cilin përcaktohen subvencionet në lëmin e biznesit, e në harmoni me Përfundimin e Bordit të Drejtorëve 01 nr. 06-57338 i miratuar në mbledhjen e mbajtur me dt:24.08.2015, me të cilin është aprovuar kërkesa e Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik për subvencionimin e Qendrës Inovative në Gjakovë (JIC), për realizimin e projektit “Zyra për konsultime dhe zhvillim të biznesit”, me dt: 27.08.2015 e miraton këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik për subvencionimin e Qendrës Inovative në Gjakovë për realizimin e projektit: “Zyra për konsultime dhe zhvillim të biznesit“, duke e mbështetur realizimin e këtij projekti me subvencione të Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik në vlerë prej 5,587.70 € .
2. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që ta realizon procedurën e zotimit të mjeteve financiare në vlerë prej 5,587.70 € , nga mjetet e subvencioneve të Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik dhe bartjen e këtyre mjeteve në konton e Qendrës Inovative në Gjakovë nr. 1505030000509708 Raiffeisen Bank .
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë .
4. Vendimi iu dërgohet :
 - Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik
 - Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
 - Qendrës Inovative në Gjakovë
 - Arkivit

Kryetarja e Komunës

Znj. Mimoza Kusari – Lila